



# **culture 21**

Agenda 21 for culture  
Agenda 21 de la culture  
Agenda 21 de la cultura

**Qytetet dhe qeveritë lokale të bashkuara  
- Komiteti për kulturë**

**Indikatorët kulturorë dhe  
Agjenda 21 për kulturë**



**Ajuntament de Barcelona  
Institut de Cultura**



**United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

---

## **Indikatorët kulturorë dhe Agjenda 21 për kulturë**

Dokumenti i miratuar më 24 tetor, 2006 në Barcelonë,  
në takimin e parë të Komitetit për kulturë të QQLB-së

---

## 1. Hyrje

Në artikullin 49, Agjenda 21 për kulturë i paraqet rekomandimet e veta që “Të përmbushet, para vitit 2006, propozimi për sistem të indikatorëve kulturorë që e përkrahin shpërndarjen e kësaj Agjende 21 për kulturë, duke përfshirë këtu metoda për lehtësimin e monitorimit dhe krahasimit”. Në programin e tyre për vitet 2005-2007, anëtarët e Komitetit për Kulturë të Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara, u zotuan për zhvillim të këtij propozimi.

## 2. Indikatorët kulturorë

Puna që duhet të bëhet mbi indikatorët kulturorë lokalë është fushë e fragmentarizuar dhe i mungon konsensusi. Sidoqoftë, zhvillimi i tyre është thelbësorë për t’u siguruar që kultura të konsolidohet si një nga shtyllat e zhvillimit. Gjatë disa viteve të fundit, është rritur interesimi për indikatorët kulturorë dhe janë shkruar dhe publikuar disa raporte për këtë temë.

Në nivel ndërkombëtar, raporti i vitit 2004 i bërë nga Federata Ndërkombëtare e Këshillave dhe Agjencive Artistike - IFACCA (**[www.ifacca.org](http://www.ifacca.org)**) është i një rëndësie shumë të madhe; dy konkluzionet kryesore të tij raporti kanë të bëjnë me çështjet analitike dhe koordinuese<sup>1</sup>:

- Sa ju përket çështjeve analitike, raporti thotë që “Indikatorët kulturorë si dhe indikatorët tjerë socialë, ende nuk janë të zhvilluar mirë, në veçanti ata që kanë të bëjnë me politik bërjen dhe me ofrimin e programeve. Prandaj, ka arsye për të qenë të matur rreth kornizave të indikatorëve kulturorë që janë zhvilluar deri më tani. Problemet e zakonshme analitike përfshijnë: “Konfuzionin rreth asaj se si janë indikatorët tash dhe si do duhej të jenë”, “Mungesën e të dhënave kualitative”, “Kornizat nuk janë shumë bindëse”, dhe “Objektivat politike janë të paqarta”.
- Sa ju përket çështjeve të koordinimit, raporti thotë se: “ka pak kontakt në mes të agjencive që aktualisht janë duke i zhvilluar indikatorët kulturorë. Dy probleme kyçe që mund të zbuten me shkëmbim dhe koordinim më të mirë janë: “Shumëllojshmëria e punës” dhe “Dallimet në qasje”.

---

<sup>1</sup> Federata Ndërkombëtare e Këshillave të Arteve dhe Agjencive Kulturorë (IFACCA); 2005; *Indikatorët Statistikorë për Politika të Arteve*,

---

Gjithashtu, në nivel global, është me rëndësi të theksohet puna që bëhet në projektin “Eurocult 21”<sup>2</sup>, në Forumin e Kulturës së Euroqyteteve, rrjetit evropian të qyteteve të mëdha. Ky projekt i ka analizuar informatat kuantitative dhe kualitative që kanë të bëjnë me politikat kulturore të qyteteve evropiane të ndryshme gjatë viteve 2002-2005.

Hulumtimi dhe zhvillimi i indikatorëve kulturorë lokalë është detyrë urgjente e cila duhet ta gjejë vendin e vet në rrjetet ndërkombëtare të qyteteve. Roli që mund ta luajë Komiteti i Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara është shumë i rëndësishëm pasi i lidhë iniciativat ekzistuese, bashkëpunon me propozimet nacionale dhe e promovon rëndësinë e temave të caktuara që ndërlidh kulturën me qytet, dhe të cilat nuk janë gjithmonë të dukshme për organizatat nacionale dhe ndërkombëtare që merren me indikatorët kulturorë.

### 3. Propozimi për kornizë

Duke pasur parasysh situatën aktuale të fragmentarizuar në fushën e indikatorëve kulturorë, si dhe nevojën për tu avancuar me kujdes dhe konsensus, ky dokument nuk propozon listë të indikatorëve kulturorë lokalë. Sigurisht që nevojiten shumë vite punë për ta arritur një propozim solid me këtë temë.

Megjithatë, ky dokument e sugjeron një kornizë për t’i shpjeguar politikat kulturore lokale. Kjo kornizë mund t’u ndihmojë qyteteve dhe qeverive lokale t’i qartësojnë bazat konceptuale të politikave kulturore dhe të bëhet hap i parë i progresit drejt indikatorëve kulturorë. Po ashtu mund të konsiderohet si kornizë e indikatorëve kualitativë mbi politikat kulturore dhe kornizë për qytetet dhe qeveritë lokale për t’i “vetë-vlerësuar” politikat kulturore lokale.

Propozimi për kornizën është i ndarë në dy pjesë: e para i dedikohet shpjegimit të politikave kulturore lokale (aneksi 1) dhe e dyta shpjegimit të projektit ose të mostrës (aneksi 2).

Komiteti i QQLB-së për kulturë i fton qytetet dhe qeveritë lokale që dëshirojnë t’i përgjigjen kësaj kornize, që t’i kontaktojnë ata në [agenda21cultura@bcn.cat](mailto:agenda21cultura@bcn.cat) ose [info@cities-localgovernments.org](mailto:info@cities-localgovernments.org).

---

<sup>2</sup> Tri publikimet e Eurokultit 21 mund të shkarkohen nga uebfaqja [www.eurocult21.org](http://www.eurocult21.org).

---

# Aneksi 1

## SHPJEGIMI I POLITIKËS KULTURORE LOKALE

Shpjegimi i politikave kulturore lokale mund të bëhet nga prizma të ndryshëm. Gjithmonë është vështirë të balancohet nevoja për t'i klasifikuar seritë e iniciativave/strategjive dhe për të mos e humbur ndenjën për tërësinë (në këtë rast politikën kulturore lokale). Paragrafët në vijim bazohen në Agjendën 21 për kulturë dhe kanë për qëllim t'ju ndihmojnë qyteteve dhe qeverive lokale për t'i qartësuar bazat konceptuale të politikave kulturore. Po ashtu mund të konsiderohet si kornizë e indikatorëve kualitativë mbi politikat kulturore dhe kornizë për qytetet dhe qeveritë lokale për t'i "vetë-vlerësuar" politikat kulturore lokale.

### *Informatat themelore mbi qeverinë lokale*

1. Përshkrimi i komunës: lokacioni, popullata dhe informata tjera kontekstuale.
2. Përshkrimi i komunës: struktura organizative dhe buxheti (%) për kulturë.

### *Infrastruktura kulturore dhe praktikat kulturore*

3. Definicioni i kulturës dhe diversitetit/identitetit
4. Diversiteti i furnizimeve kulturore. Objektet dhe ngjarjet kulturore
5. Publiku dhe përdoruesit
6. Politikat, programet dhe projektet që e promovojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në kulturë

### *Kultura dhe përfshirja sociale*

7. Politikat, programet dhe projektet për kulturë dhe arsimin
8. Politikat, programet dhe projektet për kulturë dhe mundësitë e barabarta
9. Politikat, programet dhe projektet mbi barazinë gjinore
10. Politikat, programet dhe projektet që e promovojnë rolin e shoqërisë civile në jetën kulturore

### *Kultura, territori dhe zonat publike*

11. Politikat, programet dhe projektet për kulturë dhe planifikim/regjenerim urbanistik
12. Përdorimi i hapësirave publike për projekte kulturore
13. Bilanci territorial i furnizimeve kulturore në qytet

---

*Kultura dhe ekonomia*

14. Politikat, programet dhe projektet që shoqërohen me kulturën, industrinë kreative dhe zhvillimin ekonomik
15. Informatat dhe analizat për punësimin kulturor
16. Diversiteti i instrumenteve ekonomike dhe financiare në përkrahjen e kulturës
17. Politikat, programet dhe projektet për kulturë, mediat lokale si dhe informimi dhe teknologjitë e komunikimit (ITK)

*Qeverisja e politikave kulturore*

18. Njohja dhe zbatimi i të drejtave kulturore në nivel lokal
19. Miratimi i Agjendës 21 për kulturë
20. Departamenti(et) komunale përgjegjëse për kulturë
21. Kompetencat në kulturë të qeverisë lokale, të dala nga legjislacioni nacional apo rajonal. Fushat tjera që mbulohen nga administrimi kulturor
22. Ekzistenca e strategjisë së formuluar kulturore lokale. Misioni dhe objektivat
23. Ekzistenca e strukturave pjesëmarrëse, si këshilli kulturor
24. Vlerësimi i politikave kulturore. Përdorimi i statistikave dhe indikatorëve kulturorë
25. Çështjet aktuale për politikë kulturore
26. Prezenca e kulturës në planet lokale/ strategjitë zhvillimore lokale
27. Pjesëmarrja e qeverisë lokale në përcaktimin e politikave kulturore provinciale/ rajonale/shtetërore
28. Pjesëmarrja e qeverisë lokale në rrjetet ndërkombëtare dhe projektet ndërkombëtare të bashkëpunimit kulturor

---

## Aneksi 2

### SHPJEGIMI I LËNDËS SË STUDIMIT

Lënda e studimit është një projekt ose program, të cilin qyteti e zgjedhë si shembull të politikës së tij kulturore. Lënda e studimit mund të jetë projekt që udhëhiqet nga administrata publike, nga agjenti privat apo ndonjë OJQ. Për hartimin e lëndës së studimit, rekomandohet struktura në vijim:

1. Titulli i projektit
2. Konteksti : Situata bazë, problemet që adresohen, parashikimi i vështirësive
3. Përmbajtja : Veprimet e zbatuara.
4. Administrimi: Drejtimi, udhëheqja, partneriteti, afati kohor, resurset, buxheti.
5. Qëndrueshmëria. Vlerësimi i projektit. Kushtet të për tu miratuar nga qytetet tjera.
6. Më shumë informacione: dokument, libër, uebfaqe.
7. Kontakt personi

**United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

carrer Avinyó, 15  
E-08002 Barcelona  
Espanya

Tel: +34 93 342 87 50  
Fax: +34 93 342 87 60  
info@cities-localgovernments.org  
www.cities-localgovernments.org

**Ajuntament de Barcelona -  
Institut de Cultura**

Palau de la Virreina - la Rambla 99  
E-08002 Barcelona  
Espanya

Tel: +34 933 161 000  
Fax: +34 933 161 020  
agenda21cultura@bcn.cat  
www.bcn.cat/cultura

**[www.agenda21culture.net](http://www.agenda21culture.net)**



**United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**



**Ajuntament de Barcelona  
Institut de Cultura**